



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 25.2.2025

Nr: 180

Ora: 14:00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE “PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR”, ME KRYETAR Z. GJOVALIN SHQALSHI, PËR REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 11 MAJ 2025

Sot më datë 25.2.2025, në seancë publike mora në shqyrtim kërkesën nr. 1268, Prot., datë 24.02.2025, me:

Kërkues: Partia politike “Personat me Aftësi të Kufizuar”, me Kryetar Z. Gjovalin Shqalshi

Objekti: Regjistrimi i partisë politike “Personat me Aftësi të Kufizuar” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025

Baza ligjore: Neni 64 i ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 399 datë 5.12.2024 ka caktuar datën 11 Maj 2025 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvend.

Partia “Personat me Aftësi të Kufizuar”, me Kryetar, Z. Gjovalin Shqalshi, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend që do të zhvillohen më datë 11 Maj 2025.

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

- Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, datë 24.02.2025, nëpërmjet të cilit vërtetohet se Partia “Personat me Aftësi të Kufizuar”, me iniale “PPAK”, me Kryetar Z. Gjovalin Shqalshi, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre.
- Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02)
- Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03)

Data: 25.2.2025 Nr:180
Ora: 14:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Personat me Aftësi të Kufizuar” me Kryetar z. Gjovalin Shqalshi, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025”

Nga dokumentacioni si më sipër dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është Partia “Personat me Aftësi të Kufizuar” me shkronja nistore “PPAK”, me adresë: Rruga "Don Bosko", Kulla Nr.5 Tiranë;
- b) Kryetar i partisë është Z. Gjovalin Shqalshi, me adresë: Lagjja Nr.2, Laç, Kurbin;
- c) Financieri i partisë është Zj. Diella Lufi, me adresë: Lezhë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është Z.Genc Tepelena, me adresë: Rruga "Don Bosko", Kulla Nr.5, Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga Partia “Personat me Aftësi të Kufizuar”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1, të nenit 64, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues i kërkesës, i paraqitur nga Partia “Personat me Aftësi të Kufizuar” është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, 64 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, si dhe të Udhëzimit nr. 2, datë 22.01.2025, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 Maj 2025.

V E N D O S :

1. Regjistrimin e partisë politike Partia “Personat me Aftësi të Kufizuar”, me Kryetar Z. Gjovalin Shqalshi, me shkronjat nistore “PPAK”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Illirjan CELIBASHI